






KRIMINALITETI NË PANDEMI



Autore: Gzime Hashani

Ekipi redaktues: Betim Musliu, Ehat Miftaraj, Gzim Shala dhe Yll Zekaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

Ky botim është produkt i projektit “Kërko Drejtësi: Fuqizimi i qasjes në drejtësi në Kosovë”, i cili mbështetet nga Departamenti i Shtetit Amerikan përmes Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe zbatohet nga Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD në partneritet me Iniciativa për Progres – INPO.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Janar, 2021

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive	5
2. Metodologjia	6
3. COVID-19 dhe kriminaliteti	7
4. COVID-19 dhe kriminaliteti në Kosovë	8
4.1. Veprat penale kundër jetës dhe trupit.....	9
4.2. Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut	9
4.3. Veprat penale kundër martesës dhe familjes.....	10
4.4. Veprat penale të narkotikëve	11
4.5. Veprat penale kundër pasurisë	11
5. Përfundime	13

LISTA E SHKURTESAVE

IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPRKS	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
Periudha e Pandemisë	Për qëllime të këtij raporti, periudha mars-dhjetor 2020
PK	Policia e Kosovës
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
ZKSH	Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit

1. Përmbledhje ekzekutive

Shpërthimi i pandemisë së COVID-19 ka ndikuar edhe në trendet e kriminalitetit. Rreth 10 muaj pas shfaqjes së rasteve të para me COVID-19 në Kosovë, IKD ka bërë një analizë përmes të cilës ka pasqyruar ndryshimet e trendit të kriminalitetit, të cilat ndryshime konsistojnë në uljen apo ngritjen e kriminalitetit sipas llojit të tij.

Gjetjet e IKD-së tregojnë se gjatë periudhës së pandemisë (mars - dhjetor 2020) në Kosovë, është ngritur numri vrasjeve të rënda për 1 rast më shumë, nga 11 në 12 raste. Por, rritje ka pasur veçanërisht në rastet e vrasjeve, ku përdherisa në periudhën e njëjtë kohore të vitit 2019 ishin pranuar në Policinë e Kosovës katër (4) raste të vrasjeve, gjatë periudhës së pandemisë janë pranuar gjithsej 11 raste. Pra, për të dy (2) lloj vrasjet, si total, ngritje gjatë pandemisë ka pasur për 53.33%. Ngritje ka pasur edhe sa i përket veprave penale të ngacmimit ku nga 379 raste në periudhën e njëjtë të vitit 2019, në periudhën e pandemisë janë pranuar 402, pra 6.06% më shumë.

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, ulje të kriminalitetit ka pasur sa i përket veprave penale të kanosjes, ku nga 1,838 raste gjatë periudhës së njëjta në vitin 2019, ky numër ka rënë në 1,672 raste në periudhën e pandemisë, derisa sa i përket rasteve të sulmit, ky numër ka rënë nga 1,111 raste në 898 raste.

Lidhur me veprat penale kundër martesës, IKD gjen se ka pasur disa lëvizje jo të shumë të theksuara të kriminalitetit, përjashtimisht dhunës në familje. Gjatë periudhës kohore prill-dhjetor 2020, Policia e Kosovës ka pranuar gjithsej 1,212 raste të dhunës në familje. Gjatë periudhës së njëjtë

kohore të vitit 2020, Policia e Kosovës ka pranuar 1,404 raste, pra 191 raste më shumë. Shprehur në përqindje, del se gjatë periudhës së pandemisë, dhuna në familje është rritur për 15.75%.

Sa i përket veprave penale të narkotikëve, IKD gjen se ka ulje të trendit të kriminalitetit sa i përket veprave penale që ndërlidhen me blerje apo shpërndarje dhe posedim të narkotikëve. Nga 290 raste që ndërlidhen me blerje, posedim dhe shpërndarje të narkotikëve, gjatë periudhës së pandemisë ky numër ka rënë në 207, pra numri i rasteve është ulur për 28.62%. Ndërsa, sa i përket posedimit të paautorizuar të narkotikëve, ky numër ka rënë nga 902 raste në 740 raste, pra ka pasur ulje për 17.96%. Por në anën tjetër, gjatë periudhës së pandemisë janë ngritur veprat penale të kultivimit të narkotikëve. Nga 23 raste në periudhën e njëjtë të vitit 2019, gjatë pandemisë Policia e Kosovës ka pranuar 35 raste të kësaj natyre. Shprehur në përqindje, ngritja e numrit të rasteve për këtë vepër penale ka qenë 52.17%.

Gjatës periudhës së pandemisë, IKD ka gjetur po ashtu se, ka një ngritje të trendit të kriminalitetit sa i përket veprave penale kundër të drejtave dhe lirive themelore. Në këtë drejtim, sa i përket veprave penale rrëmbimi, shtrëngimi dhe fotografimet/inqizimet e paautorizuara, numri është rritur nga 48 raste në 71 raste. Pra, për këto vepra penale ka pasur rritje për 47.91%.

Ndërsa, sa i përket uljes së trendit të kriminalitetit gjatë pandemisë, gjetjet e IKD-së tregojnë se, shprehur në numër të rasteve, ulja më e madhe e këtij trendi ka qenë në raport me veprat penale kundër

pasurisë. Përkatësisht, IKD ka gjetur se gjatë kohës së pandemisë, ka pasur numër më të vogël të rasteve të vjedhjeve, ku krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019 kur nga Policia e Kosovës ishin pranuar 3,754 raste, gjatë periudhës së pandemisë janë pranuar 3,164 raste, përkatësisht 15.71% më pak. Sa i përket vjedhjeve të rënda, ky numër ka rënë gjatë pandemisë nga 3,065 raste në 2,640 raste. Përkatësisht, gjatë periudhës së pandemisë janë pranuar 13.86% më pak lëndë të kësaj natyre. Ndërsa, sa i përket grabitjeve, ky numër ka rënë nga 126 raste në 112 raste, apo për 12.5%.

2. Metodologjia

Pas rreth 10 muajve të shfaqjes së pandemisë COVID-19 në Kosovë, IKD në këtë raport ka paraqitur trendët e kriminalitetit gjatë periudhës kohore të pandemisë COVID-19. Me këtë rast, për qëllime të këtij raporti, “*periudha e pandemisë*” përfshinë periudhën kohore mars – dhjetor 2020.

Hulumtues të ndryshëm edhe sot thonë se ndryshimet e trendëve të kriminalitetit gjatë pandemisë nuk mund të përcaktohen në mënyrë precize, por se ka disa indikatorë për këtë.

IKD në këtë raport i është referuar vetëm të dhënave statistikore të Policisë së Kosovës. Arsyeja pse nuk janë trajtuar të dhënat e Prokurorit të Shtetit dhe gjykatave ka të bëjë me faktin se rastet e pranuar në këto institucione kanë të bëjnë me faza të mëvonshme procedurale, i cili fakt bënë që këto të dhëna mos të pasqyrojnë realitetin kohor të kohës së kryerjes së një veprë penale.

Sa i përket të dhënave statistikore të Policisë së Kosovës, IKD ka krahasuar periudhën kohore mars-dhjetor 2019 dhe mars-dhjetor 2020, ku ka evidentuar lëvizjet e theksuara në trendin e kriminalitetit. Me këtë rast, IKD në këtë raport ka theksuar lëvizjet të cilat ndërtojnë argumentin për ndryshim të trendit të kriminalitetit, derisa veprat penale në të cilat nuk ka pasur ndryshime të theksuara nuk janë përfshirë në këtë raport, dhe rrjedhimisht nënkuptohet se për të njëjtat, nuk ka pasur lëvizje gjatë periudhës së pandemisë. Përfundimisht sa i përket periudhës kohore bënë vepra penale e dhunës në familje, ku nga analiza është larguar muaji mars i të dy (2) viteve, pasi dhuna në familje si vepër penale, është e paraparë me kodin e ri penal, i cili ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2019.

Me këtë rast, IKD e ka parasysh faktin se trajtimi i rasteve në Policinë e Kosovës është i një faze shumë të hershme, e cila fazë nuk garanton as faktin nëse me të vërtetë janë kryer veprat penale që figurojnë në statistika dhe as kualifikimin ligjor të këtyre veprave penale. Por, në nxjerrjen e këtij trendi, këto të dhëna janë mundësia e vetme përmes të cilave pasqyrojmë trendin e kriminalitetit gjatë periudhës së pandemisë.

Në përpunimin e të dhënave, me qëllim të ndërtimit të gjetjeve të sakta dhe të drejta, IKD ka përdorur metodën statistikore dhe metodën analitike. Në fillim të këtij raporti trajtohet përgjithësisht objekti i raportit, derisa gjetjet e IKD-së përkitazi me kriminalitetin gjatë periudhës së pandemisë pasqyrohen si në formë të përgjithshme ashtu edhe në formë të detajuar.

3. COVID-19 dhe kriminaliteti

Për shkak të ngritjes së numrit të të infektuarve nga të gjitha shtetet e botës, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), më 11 mars 2020 e kishte shpallur virusin korona COVID19 si pandemi globale.¹

Me shfaqjen e pandemisë së re, pothuajse të gjitha shtetet e botës kishin ndërmarrë masa kufizuese për qytetarët, me qëllim të parandalimit të përhapjes së pandemisë.

Masat anti-COVID-19 kishin ndikim rrënjësisht në shumë fusha, veçanërisht në atë ekonomike.

Por, ndikimi i këtyre masave, nuk u kufizua as në drejtësi. Kjo pasi gjatë aplikimit të masave anti-COVID-19, në shumë vende të botës pati ndryshime të trendëve të kriminalitetit.

Më 27 mars 2020, EUROPOL kishte publikuar artikullin “Si përfitojnë kriminelët nga pandemia COVID-19²”.

“Një numër i masave kanë një ndikim të rëndësishëm në peizazhin e krimit të rëndë dhe të organizuar. Kriminelët kanë qenë të shpejtë për të shfrytëzuar mundësitë për të përdorur krizën dhe përshtatur mënyrat e tyre të punës apo duke u përfshirë në

veprimtari të reja kriminale” thuhej në këtë artikull³.

Sipas UN Women, “Që nga shpërthimi i COVID-19, të dhënat kanë treguar se të gjitha llojet e dhunës ndaj grave dhe vajzave, veçanërisht dhuna në familje, janë intensifikuar”⁴.

Sipas hulumtueses amerikane Rebecca Edwards, “Nga pikëpamja e hulumtimit, edhe pas gjashtë (6) muajve jetesë me COVID-19 është e vështirë të ndërtosh një supozim gjithëpërfshirës. Por, ka shenja të qëndrueshme se në të gjithë vendin, disa krime kanë pasur rritje. Rritjet më të mëdha kanë qenë në krimet e dhunshme, veçanërisht vrasjet, sulmet e rënda dhe incidentet me armë.”⁵

¹ "Rolling updates on coronavirus disease (COVID-19)" WHO. 31 July 2020. (Shih linkun <https://www.who.int/emergencies/diseases/novel-coronavirus-2019/events-as-they-happen>). (Qasur për herë të fundit më 15 tetor 2020).

² "How criminals profit from the COVID-19 pandemic". Europol. 27 mars 2020. (Shih linkun <https://www.europol.europa.eu/newsroom/news/how-criminals-profit-covid-19-pandemic>). (Qasur për herë të fundit më 19 janar 2021).

³ Po aty.

⁴ "Press release: UN Women raises awareness of the shadow pandemic of violence against women during

COVID-19". UN WOMEN. 27 maj 2021. (Shih linkun

<https://www.unwomen.org/en/news/stories/2020/5/press-release-the-shadow-pandemic-of-violence-against-women-during-covid-19>). (Qasur për herë të fundit më 19 janar 2020).

⁵ Edwards R. "Crime and the Coronavirus: What You Need to Know". Safewise. 4 dhjetor 2021. (Shih linkun <https://www.safewise.com/blog/covid-19-crimes/>). (Qasur për herë të fundit më 19 janar 2021).

4. COVID-19 dhe kriminaliteti në Kosovë

Rastet e para me COVID-19 në Kosovë ishin konfirmuar me 13 mars 2020. Pas konfirmimit të rasteve të para me COVID-19, Qeveria e Republikës së Kosovës, me 15 mars 2020, kishte nxjerrë vendim për shpalljen e gjendjes së emergjencës së shëndetit publik.

Pas këtij vendimi, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Shëndetësisë kishin ndërmarrë një varg masash kufizuese. Ndër më kryesoret, ishte kufizimi i lirisë së lëvizjes për qytetarët në orare të caktuara, të cilat orare kanë ndryshuar vazhdimisht.

Si masa të tjera kufizuese krahas lirisë së lëvizjes, ndër të tjera, ishte edhe kufizimi i punës të një numri të konsiderueshëm të bizneseve.

Po ashtu, pas vendimeve të marra nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) edhe puna e gjykatave dhe prokurorive ishte kufizuar, gjegjësisht, puna në këto institucione kishte vazhduar vetëm me staf esencial ndërsa punohej vetëm me lëndë emergjente të cilat nuk duronin pritje.

Sa i përket kriminalitetit, IKD në këtë hulumtim ka paraqitur trendet e kriminalitetit gjatë periudhës së pandemisë, me të dhënat e gjeneruara sipas metodologjisë së cekur në fillim të këtij raporti.

Gjetjet e IKD-së dëshmojnë se nga të gjitha kategoritë e veprave penale sipas Kodit Nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, në pesë (5) prej tyre ka ndryshim

të trendit të kriminalitetit, i cili ndryshim konsiston në uljen apo ngritjen e rasteve.

Në këtë drejtim, IKD pasi ka analizuar tërësinë e të dhënave statistikore sipas të gjitha veprave penale sipas Kodit Nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, ka gjetur se në kapitujt e tjetër të këtij Kodi, nuk ka ndryshime të theksuara, të atij niveli që mund të vijmë në përfundim nëse në atë kategori të veprave penale ka pasur ulje apo ngritje të trendit të kriminalitetit.

Në anën tjetër, për asnjë prej kategorive të veprave penale ku gjatë periudhës së pandemisë është evidentuar ndryshim i trendit të kriminalitetit, nuk mund të vijmë në përfundim se ka pasur ndryshime të theksuara për gjithë kategorinë e veprave penale. Por, përfundime të tilla mund të nxjerrim për vepra të veçanta penale brenda këtyre kategorive të veprave penale.

Në këtë drejtim, IKD gjen se gjatë periudhës së pandemisë në Republikën e Kosovës ka pasur ngritje të vrasjeve të rënda dhe veçanërisht të vrasjeve. Po ashtu, sa i përket kapitullit të veprave penale kundër jetës dhe trupit, IKD gjen se gjatë periudhës së pandemisë ka pasur ngritje të veprave penale të ngacmimit, derisa ka pasur ulje të veprave penale të kanosjes dhe sulmit.

Lidhur me veprat penale kundër martësë IKD ka gjetur se nuk ka ndonjë lëvizje të madhe të kriminalitetit, përjashtimisht dhunës në familje, e cila vepër penale gjatë periudhës së pandemisë ka shënuar ngritje për 15.75%.

Sa i përket veprave penale të narkotikëve, IKD gjen se ka ulje të trendit të kriminalitetit sa i përket veprave penale që ndërliken me blerje apo shpërndarje dhe

posedim të narkotikëve, derisa ka ngritje të kriminalitetit sa i përket kultivimit të narkotikëve.

Gjatës periudhës së pandemisë, IKD ka gjetur po ashtu se ka një ngritje të trendit të kriminalitetit sa i përket veprave penale kundër të drejtave dhe lirive themelore.

Ndërsa, sa i përket uljes së trendit të kriminalitetit gjatë pandemisë, IKD gjen se ulja më e madhe e këtij trendi ka qenë në raport me veprat penale kundër pasurisë. Përkatësisht, IKD ka gjetur se gjatë kohës së pandemisë, ka pasur numër më të vogël të rasteve të vjedhjeve, vjedhjeve të rënda dhe grabitjeve.

Në vijim të këtij raporti, IKD ka paraqitur të dhëna për trendit e kriminalitetit gjatë pandemisë sa i përket të gjitha kategorive të veprave penale në të cilat janë identifikuar ndryshime të atij niveli që flasin për ndryshimin e një trendi të caktuar.

4.1. Veprat penale kundër jetës dhe trupit


Kodi Nr.06/L-074 Penal i Kosovës i cili ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2019, parasheh kapitull të veçantë me të cilin inkriminohen veprat penale kundër jetës dhe trupit.

Në kuadër të kapitullit XVI të këtij Kodi, *“Veprat penale kundër jetës dhe trupit”*, hyjnë vrasja, vrasja e rëndë, vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore, vrasja nga pakujdesia, kanosja, ngacmimi, sulmi etj.

Sa i përket veprave penale kundër jetës dhe trupit, gjatë periudhës së pandemisë, në raport me periudhën e njëjte të vitit paraprak, ka pasur ngritje të numrit të tri (3) llojet e vrasjeve. Nga katër (4) vrasje sa kishin qenë gjatë periudhës së njëjtë të vitit

2019, gjatë periudhës së pandemisë në Policinë e Kosovës janë pranuar 11 raste të vrasjeve. Rritje për nga një (1) rast gjatë periudhës së pandemisë ka pasur për veprën penale të vrasjes së rëndë dhe vrasjes nga pakujdesia. Po ashtu, gjatë periudhës së pandemisë janë ngritur edhe rastet e ngacmimit.

Në anën tjetër, sa i përket kësaj kategorie të veprave penale, gjatë periudhës së pandemisë ka pasur më pak raste për veprat penale të kanosjes dhe sulmit.



Grafika 1: Statistikat e Policisë për veprat penale kundër jetës dhe trupit.


4.2. Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në kapitullin e dytë të saj, përcakton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të cilat janë të garantuara me këtë kushtetutë.

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut mbrohen edhe përmes inkriminimit të veprimeve me të cilat cenohen apo dëmtohen këto të drejta. Kodi Nr.06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës në kapitullin

XVII, “Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut”, inkriminon veprat penale si rrëmbimi, shtrëngimi, fotografimi dhe incizimet tjera të paautorizuara etj.

Gjatë periudhës së pandemisë, ka pasur ulje të rasteve të rrëmbimeve, derisa ka pasur ngritje të veprave penale “shtrëngimi”. Ndërsa, një rritje e konsiderueshme e rasteve është paraqitur në raport me veprën penale të fotografimit dhe incizimeve të tjera të paautorizuara.




Grafika 2: Statistikat e Policisë për veprat penale kundër të drejtave dhe lirive të njeriut.

4.3. Veprat penale kundër martesës dhe familjes

Veprat penale me të cilat cenohen të drejtat që ndërlidhen me martesën dhe familjen janë të inkriminuara edhe me kapitullin XXI të Kodit Nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, në të cilin kapitull bëjnë pjesë veprat penale si dhuna në familje, bigamia, mundësimi i lidhjes së martesës së kundërligjshme, martesa e detyruar, bashkësia jashtëmartesore me personin nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet etj.


Sa i përket dhunës në familje, gjatë periudhës së pandemisë, dhuna në familje është ngritur për 15.75%. Përkatësisht, numri i rasteve të dhunës në familje gjatë periudhës së pandemisë është ngritur për 191 raste, nga 1,212 në 1,403.



Grafika 3: Rritja e rasteve të dhunës në familje gjatë vitit 2020.

Sa i përket veprave të tjera penale nga ky kapitull, IKD gjen se ka pasur rënie të kriminalitetit gjatë periudhës së pandemisë COVID-19. Konkretisht, ka pasur rënie të kriminalitetit sa i përket veprave penale të shkeljes së detyrimeve familjare, keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës, marrja apo mbajtja e kundërligjshme e fëmijës dhe shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës.

Pra, sa i përket veprave penale nga kapitulli i veprave penale kundër familjes shihet se nuk ka dallime shumë të theksuara, përjashtimisht veprës penale të dhunës në familje.



Grafika 4: Statistikat për veprat penale kundër martesës dhe familjes.


4.4. Veprat penale të narkotikëve

Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës në kapitullin XXIII parasheh “Veprat penale të narkotikëve”, në kuadër të cilit kapitull, ndër të tjera, hyjnë edhe veprat penale “blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”, “posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge”, “kultivimi i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit” etj.

Sa i përket veprës penale “blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”, IKD ka gjetur se gjatë periudhës së pandemisë ka pasur rënie të kriminalitetit

për 28.62%. Po ashtu, rënia të kriminalitetit ka pasur edhe sa i përket veprës penale “posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge”, e cila rënie shprehur në përqindje ka qenë 17.96%.

Por, sa i përket veprave penale të narkotikëve, IKD gjen se gjatë periudhës së pandemisë ka pasur ngritje të veprave penale të “kultivimit të bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit” për 59.09%.



Grafika 5: Statistikat për veprat penale të narkotikëve.

4.5. Veprat penale kundër pasurisë

Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, në kapitullin XXVI inkriminon veprat penale kundër pasurisë, në të cilin kapitull, ndër të tjera, hyjnë vepra penale e vjedhjes, vjedhjes së rëndë dhe grabitjes,

trendët e të cilave veprave penale kanë ndryshuar gjatë periudhës së pandemisë.

Sa i përket këtyre veprave penale, IKD gjen se gjatë periudhës së pandemisë ka pasur ulje të kriminalitetit.


Sa i përket veprave penale të vjedhjes, në raport me periudhën paraprake, gjatë periudhës së pandemisë në Policinë e Kosovës janë pranuar 590 raste më pak. Përkatësisht, gjatë periudhës së pandemisë, numri i vjedhjeve ka rënë nga 3,754 raste që ishin raportuar gjatë vitit 2019, në 3,164 raste që ishin raportuar gjatë periudhës së njëjtë në vitin 2020. Shprehur në përqindje, i bie se në raport me këtë vepër penale, gjatë periudhës së pandemisë ka pasur ulje të kriminalitetit për 15.7%.

Ulje të kriminalitetit gjatë pandemisë ka pasur edhe sa i përket veprave penale të vjedhjeve të rënda. Sa i përket kësaj vepre penale, në raport me periudhat paraprake, gjatë periudhës së pandemisë në Policinë e Kosovës janë pranuar 425 raste më pak. Përkatësisht, gjatë periudhës së pandemisë, numri i vjedhjeve të rënda ka rënë nga 3,754 raste sa ishin raportuar në vitin 2019 në 2,640 raste që ishin raportuar gjatë periudhës së pandemisë në vitin 2020. Shprehur në përqindje i bie se gjatë periudhës së pandemisë, në raport me veprën penale të vjedhjeve të rënda, kriminaliteti ka rënë për 13.86%.

Po ashtu, gjatë periudhës së pandemisë, ulje të kriminalitetit ka pasur edhe në raport me veprat penale të grabitjeve.

Gjatë periudhës së pandemisë, trendi i rasteve të veprave penale të grabitjeve të pranuar nga Policia e Kosovës ka rënë për 11.11%. Përkatësisht, për dallim nga periudha mars-dhjetor 2019, kur ishin

raportuar 126 raste të grabitjeve, gjatë periudhës së pandemisë në vitin 2020, numri i rasteve të veprave penale të grabitjeve ka rënë në 112.



Grafika 6: Statistikat për veprat penale kundër pasurisë.

5. Përfundime

Gjatë periudhës së pandemisë në Republikën e Kosovës, kriminaliteti është ngritur për këto vepra penale:

- Vrasje (Nga 4 në 11 raste – 175%)
- Vrasje të rënda (Nga 11 në 12 raste – 9.09%)
- Ngacmime (Nga 379 në 402 raste - 6.06%)
- Dhunë në familje (Nga 1.200 në 1,400 raste - 15.7%)
- Kultivimi i bimës së hashashit,
shkurren së kokainës ose bimëve të kanabisit (Nga 23 në 35 raste - 52.17%)
- Shtrengim (Nga 8 në 14 raste – 75%)
- Fotografimi dhe incizimet tjera
të paautorizuara (Nga 27 në 47 raste – 74.07%)

Ndërsa, gjatë periudhës së pandemisë në Republikën e Kosovës, kriminaliteti ka zbritur për këto vepra penale:

- Vjedhje (Nga 3,754 në 3,164 raste - 15.71%)
- Vjedhje të rënda (Nga 3,065 në 2,640 raste - 13.86%)
- Grabitje (Nga 126 në 112 raste - 11.11%)
- Kanosje (Nga 1,838 në 1,672 raste - 9.03%)
- Sulm (Nga 1,111 në 898 raste - 19.17%)
- Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja
e paautorizuar e narkotikëve (Nga 290 në 207 raste – 28.62%)
- Posedimi i paautorizuar i narkotikëve,
substancave psikotrope ose analoge (Nga 902 në 740 raste – 17.09%)
- Rrëmbim (Nga 13 në 10 raste – 23.07%)